SUKSES I SOPRANOS SHQIPTARE ME FAMË BOTËRORE, ERMONELA JAHO, NË COVENT GARDEN OPERA HOUSE NË LONDËR
17 QERSHOR 2013

Shkruan: Mal Berisha
Ambasador i RSH-së në Mbretërinë e Bashkuar

La Rondine (Dallëndyshja) Premjerë.

17 qershor 2013. Teatri Londinez – Covent Garden Opera House – vazhdon jetën e tij të përditshme. Në njerën anë të tij, në skene ka mbledhur artistë nga më të mirët e globit. Nga ana tjetër mbushet me spektatorët më sqimëtare të botës, me shijen më të hollë për muzikën, me elitën e ndjekësve të muzikës klasike londineze të cilët nuk falin as gabimin më të thjeshtë, as rrëshqitjen më të vogël zanore. Për Teatrin Mbretëror kjo është një ditë e rëndësishme si çdo ditë premjere. Është shfaqja e njërës prej operave më të bukura të një autori me emër të madh, Xhiakomo Puçini. Është *La Rondine* (Dallëndyshja). Në këtë natë të shënuar, ku një numër i pafund teatrosh londinezë hapin siparin e tyre, në Covent Garden Opera House ka diçka të jashtëzakonshme, jo vetëm për audiencën e kësaj shfaqje por më shumë se për këdo, për ne shqiptarët e Britanisë së Madhe. Kjo natë është e jashtëzakonshme sa për artisten Ermonela Jaho aq edhe për Ambasadën Shqiptare në Londër dhe lidhet me emrin dhe reputacionin e shqiptarëve në Britaninë e Madhe. Është Diva Globale e cila këtë skenë ka vite që e shkel, dhe sa herë që vjen, aq herë e shton numrin e pasonjësve të vet. Sa here që vjen, aq herë ua rrit krenarinë shqiptarëve në këtë vend ku arti çmohet ndoshta më shumë se çdogjë tjetër. Po kush është Ermonela në fakt, ashtu siç i është paraqitur ajo publikut londinez në përshkrimin e bërë në librin shoqërues të biletës për artistët interpretues të kësaj Opere në rolin e Madga de Civry?

"E lindur në Tiranë ajo studjoi muzikë në vendin e saj e pastaj në Romë. Ajo ka debutuar në Tiranë që e vogel duke interpretuar rolin e Violetës që kur ishte 17 vjeçe. Paraqitjet e saj të viteve të fundit para publikut përfshijnë Violetën në Royal Opera, Berlin State Opera, Opera de Lyon, Hamburg State Opera, Arena di Verona, Vienna State Opera, Deutche Opera Berlin, Bavarian State Opera, Sour Angelica Royal Opera; Cio-Cio-San e Baterflait në Filadelfia, Koln, Liceo, Barcelona; Mimin e Bohemës në Berlin State Opera, La Monnaie, Bruksel; Liun e Baterflait në Filadelfia, San Diego; Luisa Millerin dhe Anna Bolenën në Opera de Lyon; Madga de Civryn e La Rondine në Trieste Vitella, La Clemenza di Tito dhe Xhulietën në Capulleti e i Montechchi në Avignion; Micaealan në Glyndbporne, Romë, Arena di Verona; Margaritën e Faustit në Helsinki; Massenet's Manon në La Scala, Milan, Marsjejë; Madamë Baterflain e ka luajtur në operat e Hamburgut, Avinjonit, Champs Elize, Paris; Violetën në Operan e Vjenës, Mimin në Londër dhe në Lyon e sa e sa tjera".

Nëse do të vijonim me emrat e veprave dhe vendeve ku ka interpretuar Ermonela Jaho, kjo listë do të ishte shumë e gjatë. Por le të kthehemi tek "Dallëndyshja" e 17 qershorit në Covent Garden Opera House në Londër.

Opera apo Operetë?

Opera Dallëndyshja (La Rondine) e Puçinit është shkruar në vitin 1915. Ajo ishte porositur nga Caritheater i Vjenës si një opera me një libret gjerman. Puçini e shkruajti atë bazuar në libretin e Xhuzepe Adamit në gjuhën italiane. Por pikërisht atë vit Italia hyri në luftën e Parë Botërore duke patur në anën tjetër të frontit Austrinë. Të shkruante një opera për Austrinë, për patriotin italian, kompozitorin e madh Puçini, ishte e pamundur. Prandaj ai zgjodhi ta ekzekutonte veprën në premjerë në një vend asnjanës, në Monte Carlo. Premjera u dha në vitin 1917. Që prej asaj kohe kjo vepër është interpretuar shumë herë por gjithmonë është diskutuar nëse ishte opera apo operetë. Ajo nuk është as opera komike as tragjike por ka ndoshta mbylljen më melankolike në historinë e skenës operistike. Diskutimi për të vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Ermonela Jaho i jep Veprës një pamje të re.

Artistët e mëdhenj lenë gjurmë ne çdo paraqitje para publikut. Puna e artistit është përherë një punë krijuese, kërkuese elementësh të rinj, gjetjesh të mjeteve artistike të pa përdorura më parë. Ndryshe gjërat do bëheshin të zakonshme. Parë në këtë plan, ajo që sjell këngëtarja jonë në skenën mbretërore është diçka e re, diçka e dallueshme, e veçantë. Në natën e 17 qershorit ajo e mbajti publikun londinez pezull, në ajër, me frymë të ndalur. Në sallën mijëra vetësh dëgjohej vetëm tingulli i zërit të saj i shoqëruar nga një orkestër që nuk ka asgjë më pak se ajo çfarë bëhët në Mbretërinë e Muzikës – Operan Mbretërore Londineze. Zëri i saj i kthjellët, magjik, deri në prekje fundore të çdo ndjenje njerëzore me timbrin e tij është në një harmoni gati hyjnore me orkestrën, levizjet skenike, dekorin, dritat dhe tërë pamjen spektakolare të sallës. Lëvizjet e stërmenduara në skenë, kujdesi ndaj çdo detaji, aktrimi me këngen alternohen deri në atë masë sa kur bie perdja, njeriu nuk dallon dot se sa orë, vite apo jetë ka kaluar në atë sallë magjepsëse.

Shfaqja vjen me një rritje të vazhdueshme për të ardhur tek triumfi i padiskutueshëm që shpërthen në duartrokitje, mallëngjim, dhimbje, vaj, reflektim individual të çdo njeriu që gjëndet në atë sallë. Është një triumf i padiskutueshëm. Një lloj ndërthurje ndjesishë, admirimi, një lloj katarsisi ku çdo njeri e gjen veten në mënyrën e vet, një lloj meditimi emocional që përkthehet në lotë dhimbjeje, dashuri njerëzore, hyjnizim artisti, nevojë për të parë mbrapa tek e kaluara e vetvetes. Minuta të tëra duartrokitjesh, dhe zbrazëtim i asaj salle për t'i lënë vendin shfaqjes së të nesërmes.

Duke e parë Operan La Rondine në interpretimin e trupës së Covent Garden Opera House me Divë Ermonela Jahon, mendja më vajti tek rregjisori i famshëm gjerman Rejnhard i cili drejtonte Burgteatrin e Vjenës ku luante Moisiu ynë i Madh. Kritika e asaj kohe hamendësonte rreth disa shpërthimeve në interpretimin e Moisiut të karaktereve të tilla si Hamleti dhe që shfaqeshin tek artisti ynë i madh papritur, jashtë natyrës austriake. Këtë veti të tij, kritikët ia lanë origjinës së tij shqiptare. Ky konstatim kritik ndaj Moisiut tonë vjenez

më çoi të mendoja dhe të shihja në skenë një temperament tjetër, një Madga de Civry e cila i sjell Londrës një natyrë tjetër të këtij personazhi, një sjellje tjetër, shumë më të kujdesshme ndaj vlerave familjare dhe morale.

Madgi da Civry, e luajtur nga Ermonela Jaho solli para spektatorit londinez një karakter shumë të ngjashëm me një shqiptare. Puçini dhe Adami e kanë sjellë deri në fund të shfaqjes Madgan në jetën e saj aventureske dhe ata janë autorët e veprës. Por ka gjithmonë diçka të fortë, jo vetëm emocionale por edhe filozofike që artisti interpretues i vesh rolit që luan. Në këtë rast, i tërë dramaciteti i veprës ndërtohet prej artistes tonë bazuar në konfliktin e njohjes së vlerave morale, dashurisë së fortë pasionante që kërkon të ndërtojë një jetë të bukur bashkëshortore me pëlqimin e familjes, nënës së Rugeros në këtë rast nga njëra anë, dhe pengun moral të së shkuarës së saj në anën tjetër. A duhet thënë e vërteta dhe pastaj gjërat të rrjedhin si të rrjedhin? A duhet të ndërpritet ajo dashuri, që sado në dukje e panatyrëshme, ka forcë të jashtëzakonshme? A duhet marrë dashuria e çmendur e Rugeras që nuk merr parasyshë asgjë nga e kaluara, apo duhet "vrarë" ajo dashuri që pa lindur që mos të ndodhë e njejta gjë kur gjithçka të merret vesh? E tërë kjo betejë shpirtërore a Madgës – Ermonelë ka në vetvete dilemën e madhe që zakonisht e mbartin përfaqësues të kombeve me traditë ende shumë të forte morale, ku e ardhmja nuk mund të ndahet kurrësesi nga e shkuara dhe në këtë rast e dyta bëhet pengesa më serioze ndaj së parës. Kjo është tejet shqiptare në të vërtetë. Dilema deri në vendim për të lënë Rugeron, pikërisht sepse e donte atë, e trajtuar vërtetë në një mënyrë që të kujton ende një mentalitet shqiptar, e mbajti sallën në një gjëndje të plotë "kontrolli" emocional deri sa gjithçka u shkri, u tret dhe humbi thuajse në lotët e çdo spektatori përfshirë autorin e këtij shkrimi.

Mbyllje:

Performanca e Ermonela Jahos në Teatrin Mbretëror të Londrës ishte për artin shqiptar në përgjithësi, për bashkësinë shqiptare në Britani dhe për vetë Ambasadën Shqiptare në Londër në veçanti, një ngjarje e madhe artistike. Për këta të fundit, prania e saj në veprimtari të tilla e çon akrepin e opinionit britanik për shqiptarët drejt nordit të ndritshëm duke zbehur deri në zhdukje opinionin se shqiptarët dinë vetëm të emigrojnë dhe kur e bëjnë këtë e bëjne edhe me shumë problematikë për vendasit që i presin.

Ambasada në Londër pati nderin dhe krenarinë ta mirëpresë artisten e madhe në mjediset e saj dhe po ashtu ta ndjekë në shfaqje duke marrë edhe urimet më të mira nga vetë Covent Garden Opera House për arritjet e kësaj artistje të madhe shqiptare.

Mal Berisha